



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Tiranë, më datë 28. 05.2019

Nr. 214 Prot.

VENDIM

Nr. 175, datë 28.05.2019

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT TË RIKONSTRUKSIONIT

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 38, pika 2 dhe neni 72, pika 1, VKM Nr.786, datë 26.12.2018 për miratimin e "Zonave Arkeologjike "A" dhe "B" të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre", Neni 3, pika d, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 28.05.2019, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit: "Rikonstrukcion, sanitarizim, adaptim objekti" lagjja Nr.1, Bulevardi "Epidamn", në zonën arkeologjike "A" të qytetit të Durrësit, në pronësi të Z. Ilirjan Mano, hartuar nga Ing. Rest.Genc Samimi;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 72, pika 1;
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

Arta Dollani

